

**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQERISE ME PËRGJEGJËSI TE KUFIZUAR**  
**“ISHRAK” SH.P.K.**

Sot me date 06.06.2023, ne Sarande, me vullnetin tim te lire une i nenshkruari :

- Meriman Shehi, i datelindjes 09 Nentor 1993 , lindur ne Rrenxë dhe banues ne Sarande rruga “Idriz Alidhima” lagjia nr.4, mbajtes i leternjoftimit nr.personal J31109094T, me date leshimi 07 Maj 2021, i shtetesise Shqiptare.
- Hektor Binaj, i datelindjes 20 Gusht 1976 , lindur ne Fier dhe banues ne Tirane bulevardi Gjergj Fishta, mbajtes i leternjoftimit nr.personal H60820060S, me date leshimi 16 Mars 2022, i shtetesise Shqiptare

Ne zbatim te Ligjit 9901, date 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, dhe ligjit nr.9723 date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Biznesit” ,

**Neni 1**

Vendosa te themeloj shoqerine me pergjegjesi te kufizuar **“ISHRAK” shpk.**

**Neni 2**

Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete:

**Kryerjen e veprimtarise ne fushen e kembimit valuator, zyre imobilare, zyre ndermjetesimi, konsultash, sherbime turistike, tregeti plehera te ndryshem bujqesor dhe bio, konsulta psikologjike.**

Shoqeria mund te ushtroje cdo veprimatri tjeter tregetare dhe prodhuese e cila nuk ndalohet me ligj. (Neni 7 i Ligjit 9901, date 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”).

**Neni 3**

Ortakët themelues te shoqerise jane **z. Meriman Shehi dhe Z. Hektor Binaj.**

**Neni 4**

Kapitali themeltar i shoqërisë është ne vleren e 2.600.0000 leke (Dy milion e gjashtëqind mije), perbehet nga kuota ne pronesi te:

- ✓ Ortakut z. Meriman Shehi, nje kuote ne vleren e 1.300.000 (Nje milion e treqind mije)

leke ose 50%, te kapitalit themeltar te shoqerise.

- ✓ Ortakut z. Hektor Binaj, nje kuote ne vleren e 1.300.000 (Nje milion e treqind mije) leke ose 50% te kapitalit themeltar te shoqerise

#### **Neni 5**

Selia e shoqerise eshte ne Sarande, Lagjia Nr.2, bulevardi Jonianet godina me nr.14.

#### **Neni 6**

Kohezgjaria e veprimtarise se shoqerise eshte e pakufizuar ne kohe dhe fillon qe nga momenti regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit.

#### **Neni 7**

**Administrator i shoqerise do te jete z.** Hektor Binaj, i cili do te qendrojne ne kete detyre per 5 vite, me te drejte rizgjedhie dhe eshte i ngarkuar te kryeje akte dhe marre angazhime qe jane ne perputhie me objektin e veprimtarise se shoqerise.

#### **Neni 8**

Personaliteti juridik i shoqerise fitohet me regjistrimin e sajne ne regjistrin tregetar prane Qendres Kombetare te Biznesit. Aktiviteti i sajne do te filloje pas kryerjes se procedurave ligjore. Ne aktivitetin e shoqerise do ti permbahemi statutit te hartuar per kete qellim dhe do te respektoj legjislacionin ne fuqi. Kjo kontrate themelimi u redaktua ne kater kopie, me vlere te njejte ligjore, nje kopie dorzohet prane Qendres Kombetare te Biznesit , dhe nga nje kopie ortaket themelues te shoqerise.

### ***ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE "ISHRAK" SH.P.K.***

**Meriman Shehi**



**Hektor Binaj**

